



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - DEGA E GJYKATËS RAHOVEC

Numri i lëndës: 2021:113404

Datë: 26.03.2024

Numri i dokumentit: 05502696

CN.nr.33/2021

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - DEGA NË RAHOVEC, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, gjyqtari Berkan Hamza, me bashkëpunëtoreshen profesionale Adelina Çmega, në çështjen jokontestimore të propozuesit K.B nga fshati Kramovik, Komuna e Rahovecit, ndaj kundër kundërpropozuesve: I.B, H.B, II.B, E.B, M.B, A.B dhe N.B, që të gjithë nga fshati Kramovik, Komuna e Rahovecit, të cilët i përfaqëson përfaqësuesi i tyre i autorizuar Av. R.B nga Rahoveci, sipas autorizimit në shkresat e lëndës, për shkak të ndarjes fizike të paluajtshmërive të përbashkëta, pas mbajtjes së seancës së shqyrtimit kryesor më datën 11.03.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

I. APROVOHET propozimi i propozuesit K.B nga fshati Kramovik, Komuna e Rahovecit.

II. LEJOHET ndarja e paluajtshmërive të përbashkëta të parcelave të palëve ndërgjyqëse dhe në atë mënyrë:

1. Parcela kadastrale nr. 58-0, në vendin e quajtur “Lukara-Lukara” në sipërfaqe prej 21070m², shfrytëzimi aktual tokë pyjore, klasa 4, ZK. Kramovik, i takon kundërpropozuesve: M.R.B1/2 e pjesës ideale dhe N.R.B1/2 e pjesës ideale .
2. Parcela kadastrale nr. 59-0, në vendin e quajtur “Çukara- Çukara”, në sipërfaqe prej 21332m², shfrytëzimi aktual tokë bujqësore, klasa 5, ZK. Kramovik, i takon kundërpropozuesve: M.R.B1/2 e pjesës ideale dhe N.R.B1/2 e pjesës ideale .
3. Parcela kadastrale nr. 438-2, në vendin e quajtur “Selo-Selo”, në sipërfaqe prej 160m², shfrytëzimi aktual infrastruktura rrugë private, ZK. Kramovik, i takon kundërpropozuesit II.R.B1/1 e pjesës ideale.
4. Parcela kadastrale nr.439-1, në vendin e quajtur “Selo-Kod Kuqe”, në sipërfaqe prej 1623m², shfrytëzimi aktual tokë bujqësore, klasa 3, ZK. Kramovik, i takon kundërpropozuesit II.R.B1/1 e pjesës ideale.
5. Parcela kadastrale nr. 439-2, në vendin e quajtur “Selo-Kod Kuqe”, në sipërfaqe prej 401m², shfrytëzimi aktual tokë bujqësore, klasa 3, ZK. Kramovik i takon kundërpropozuesit II.R.B1/1 e pjesës ideale.

6. Parcela kadastrale nr. 440-0, në vendin e quajtur “Selo-Kod Kuqe”, në sipërfaqe prej 4267m², shfrytëzimi aktual tokë bujqësore, klasa 4, ZK. Kramovik i takon kundërpropozuesve: I.R.B1/2 e pjesës ideale dhe E.R.B1/2 e pjesës ideale.
7. Parcela kadastrale nr. 485-1, në vendin e quajtur “Luq Smonica”, në sipërfaqe prej 1139m², shfrytëzimi aktual, tokë bujqësore, klasa 5, ZK. Kramovik i takon kunderpropozuesit I.R.B1/1 e pjesës ideale.
8. Parcela kadastrale nr. 485-2, në vendin e quajtur “Luq Smonica”, në sipërfaqe prej 1360m², shfrytëzimi aktual tokë bujqësore klasa 5, ZK. Kramovik i takon kundërpropozuesit H.R.B1/1 e pjesës ideale.
9. Parcela kadastrale nr. 485-3, në vendin e quajtur “Luq Smonica”, në sipërfaqe prej 1200m², shfrytëzimi aktual tokë bujqësore, klasa 5, ZK. Kramovik takon kunderpropozuesit A.R.B1/1 e pjesës ideale.
10. Parcela kadastrale nr.485-4, në vendin e quajtur “Luq Smonica”, në sipërfaqe prej 778m², shfrytëzimi aktual tokë bujqësore Klasa 5, Z.K. Kramovik i takon: propozuesit K.R.B dhe kundërpropozuese: I.R.B, H.R.B, E.R.B, M.R.B, A.R.B dhe N.R.B me nga 1/7 e pjesës ideale.
11. Parcela kadastrale nr. 485-5 në vendin e quajtur “Luq Smonica” në sipërfaqe prej 1270m², shfrytëzimi aktual tokë bujqësore, klasa 5, ZK. Kramovik i takon kunderpropozuesit M.R.B, 1/1 e pjesës ideale.
12. Parcela kadastrale nr. 485-6 në vendin e quajtur “Luq Smonica”, në sipërfaqe prej 1245m², shfrytëzimi aktual tokë bujqësore, klasa 5, ZK. Kramovik i takon propozuesit K.R.B, 1/1 e pjesës ideale.
13. Parcela kadastrale nr. 485-7 në vendin e quajtur “Luq Smonica”, në sipërfaqe prej 1284m², shfrytëzimi aktual tokë bujqësore, klasa 5, ZK. Kramovik takon kunderpropozuesit N.R.B, 1/1 e pjesës ideale.
14. Parcela kadastrale nr. 495-1 në vendin e quajtur “Lug Smonica”, në sipërfaqe prej 676m², shfrytëzimi aktual tokë bujqësore klasa 7, ZK. Kramovik i takon: kunderpropozuesit A.R.B, 1/1 pjesës ideale.
15. Parcela kadastrale nr. 495-2 në vendin e quajtur “Lug Smonica”, në sipërfaqe prej 1180m², shfrytëzimi aktual tokë bujqësore klasa 7, ZK. Kramovik i takon kunderpropozuesit I.R.B, 1/1 e pjesës ideale.
16. Parcela kadastrale nr. 495-3 në vendin e quajtur “Lug Smonica”, në sipërfaqe prej 1348m², shfrytëzimi aktual tokë Bujqësore klasa 7, ZK. Kramovik i takon kundërpropozuesit E.R.B, 1/1 e pjesës ideale.
17. Parcela kadastrale nr. 495-4 në vendin e quajtur “Lug Smonica”, në sipërfaqe prej 378m², shfrytëzimi aktual tokë bujqësore klasa 7, ZK. Kramovik i takon: Propozuesit K.R.B dhe kundërpropozuesve; I.R.B, H.R.B, E.R.B, M.R.B, A.R.B dhe N.R.B me nga 1/7 pjesë ideale.
18. Parcela kadastrale nr. 495-5 në vendin e quajtur “Lug Smonica”, në sipërfaqe prej 1349m², shfrytëzimi aktual tokë bujqësore klasa 7, ZK. Kramovik i takon propozuesit K.R.B1/1 e pjesës ideale.

19. Parcela kadastrale nr. 495-6 në vendin e quajtur “Lug Smonica”, në sipërfaqe prej 560m², shfrytëzimi aktual tokë bujqësore klasa 7, Z.K. Kramovik i takon kunderpropozuesit M.R.B1/1 e pjesës ideale.
20. Parcela kadastrale nr. 523-0 në vendin e quajtur “Smonica-Beluha”, në sipërfaqe prej 3136m², shfrytëzimi aktual tokë bujqësore, klasa 4, ZK. Kramovik takon kundërpropozuesit E.R.B1/1 e pjesës ideale.
21. Parcela kadastrale nr. 524-0 në vendin e quajtur “Smonica-Beluha”, në sipërfaqe prej 3317m², shfrytëzimi aktual tokë bujqësore, klasa 4, ZK. Kramovik i takon kunderpropozuesit E.R.B1/1 e pjesës ideale.
22. Parcela kadastrale nr. 525-1 në vendin e quajtur “Smonica-Kodra Gjelës”, në sipërfaqe prej 2967m², shfrytëzimi aktual tokë pyjore klasa 3, ZK. Kramovik i takon kunderpropozuesit E.R.B1/1 e pjesës ideale.
23. Parcela kadastrale nr. 526-1 në vendin e quajtur “Smonica-Kodra Gjelës” në sipërfaqe prej 8164m², shfrytëzimi aktual tokë bujqësore, klasa 6, ZK. Kramovik i takon kundërpropozuesit A.R.B1/1 e pjesës ideale.
24. Parcela kadastrale nr. 555-0 në vendin e quajtur “Smonica-Kodra Gjelës” në sipërfaqe prej 6326m², shfrytëzimi aktual tokë bujqësore, klasa 4, ZK. Kramovik i takon kundërpropozuesit H.R.B1/1 e pjesës ideale.
25. Parcela kadastrale nr. 556-1 në vendin e quajtur “Smonica-Vusak”, në sipërfaqe prej 26446m², shfrytëzimi aktual tokë pyjore, klasa 3, Z.K. Kramovik i takon propozuesit K.R.B^{1/2} e pjesës ideale.
26. Parcela kadastrale nr. 556-3 në vendin e quajtur “Smonica-Vusak”, në sipërfaqe prej 261m², shfrytëzimi aktual tokë pyjore, klasa 3, ZK. Kramovik i takon kunderpropozuesit H.R.B1/1 e pjesës ideale.
27. Parcela kadastrale nr. 668-18 në vendin e quajtur “Breshinja”, në sipërfaqe prej 1801m², shfrytëzimi aktual tokë pyjore klasa 3, ZK. Kramovik i takon kundërpropozuesit I.R.B1/2 e pjesës ideale.
28. Parcela kadastrale nr. 668-19 në vendin e quajtur “Breshinja”, në sipërfaqe prej 13357m², shfrytëzimi aktual tokë bujqësore, klasa 4, ZK. Kramovik i takon kunderpropozuesit I.R.B1/2 e pjesës ideale.
29. Parcela kadastrale nr. 668-20 në vendin e quajtur “Breshinja”, në sipërfaqe prej 1951m², shfrytëzimi aktual tokë bujqësore, klasa 4, ZK. Kramovik i takon kundërpropozuesit I.R.B1/2 e pjesës ideale.
30. Parcela kadastrale nr. 668-21 në vendin e quajtur “Breshinja”, në sipërfaqe prej 12857m², shfrytëzimi aktual tokë pyjore, klasa 3, ZK. Kramovik i takon kunderpropozuesit I.R.B1/2 e pjesës ideale, dhe
31. Parcela kadastrale nr. 668-22 në vendin e quajtur “Breshinja”, në sipërfaqe prej 1901m², shfrytëzimi aktual tokë bujqësore, klasa 4, ZK. Kramovik i takon kunderpropozuesit I.R.B1/2 e pjesës ideale.

III. DETYROHEN propozuesi K.B dhe kundërpropozuesit I.B, H.B, I1.B, E.B, M.B, A.B dhe N.B, që ta pranojnë dhe të lejojnë që në bazë të këtij vendimi të regjistrohen në librat përkatës

tek Drejtoria për Gjeodezi dhe Kadastër në Prizren, e në afat prej 15 ditë nga dita e marrjes së vendimit nën kërcënim të ekzekutimit me dhunë.

IV. Shpenzimet procedurale palët i bartin në mënyrë solidare.

A r s y e t i m

Propozuesi K.B nga fshati Kramovik, Komuna e Rahovecit, në këtë gjykatë ka parashtruar propozimin për ndarjen e sendeve të paluajtshme në bashkëpronësi të parcelave kadastrale: nr.58-0, nr.59-0, nr.438-2, nr.439-1; nr.439-2; nr.440-0; nr.485-1; nr.485-2; nr.485-3; nr.485-4; nr.485-5; nr.485-6; nr.485-7; nr.495-1; nr.495-2; nr.495-3; nr.495-4; nr.495-5; nr.495-6; nr.523-0; nr.524-0; nr.525-1; nr.526-1; nr.555-0; nr.556-1; nr.556-3; nr.668-18; nr.668-19; nr.668-20; nr.668-21 dhe nr.668-22, që të gjitha ZK. Kramovik, ndaj kundërpropozuesve: I.B, H.B, II.B, E.B, M.B, A.B dhe N.B, i cili propozimi është precizuar në seancën e datës 11.03.2024.

Sipas kësaj çështje juridike jokontestimore kjo gjykatë me datë 11.03.2024 ka caktuar dhe ka mbajtur seancën shqyrtimin kryesor në prezencë të palëve ndërgjyqëse.

Propozuesi K.B në propozim, seancën e shqyrtimit kryesor dhe në fjalën përfundimtare ka deklaruar se pasi që e kanë përfunduar trashëgimin e babait të tyre të ndjerit R.B ish nga fshati Kramovik, në regjistrin e paluajtshmërive janë regjistruar si bashkëpronarë me 1/8 pjesë ideale. Palët ndërgjyqëse si vëllezër kanë interes juridik që sendet e paluajtshme në bashkëpronësi, ti ndajnë fizikisht dhe të njëjtat ti regjistrojnë në emrin e vetë në aspektin fizik. Duke shtuar se ekspertizën e ekspertit gjeometër e ka pranuar me kohë, nuk e konteston ndarjen fizike ashtu siç është paraqitur, si dhe pranon që në këtë mënyrë të kryhet ndarja fizike e paluajtshmërive. I njëjti ka theksuar se e plotëson propozimin duke u tërhequr nga propozimi sa i përket trajtimit të paluajtshmërive me nr. 00822-0, nr. 00860-0, nr. 00891-0, nr. 00896-0 dhe nr. 00898-0, të gjitha këto në ZK Cërmmjan, Komuna e Gjakovës, ndërsa pjesa tjetër mbetet e pandryshuar. Gjykatës i propozoi që ta aprovojë këtë ndarje fizike.

I autorizuari i kundërpropozuesve av. R1.B, në seancën e shqyrtimit kryesor dhe në fjalën përfundimtare ka deklaruar se nuk e konteston propozimin e propozuesit të parashtruar kësaj gjykate për ndarje të pasurisë së përbashkët të paluajtshme dhe pranon që ndarja e kësaj pasurie të bëhet sipas matjes dhe ndarjes që është bërë nga ana e ekspertit – gjeometrit Sh.H.

Gjykata me qëllim të vërtetimit të gjendjes faktike në këtë çështje jokontestimore ka bërë nxjerrjen e provës me ekspertizë të gjeodezisë, ashtu siç edhe ishte propozimi i palëve ndërgjyqëse, ndërsa për ekspert ka caktuar gjeodetin Sh.H, për kryer ekspertizën, me detyrë që të bëjë identifikimin e gjendjes faktike në terren lidhur me parcelat kadastrale që janë objekti i propozimit, ashtu siç edhe është cekur në propozim.

Gjykata ekspertin e gjeodezisë e ka ftuar në seancën gjyqësore e cila është mbajtur me datë 11.03.2024, e i cili ka qenë prezent në seancë. Ndaj të njëjtit palët ndërgjyqëse nuk kanë pasur pyetje dhe as vërejtje në ekspertizën e hartuar. Eksperti ka deklaruar se mbetet në tërësi pranë

mendimit dhe konstatimit të tij të pasqyruar në ekspertizën. Gjykata i ka falur në tërësi besimin ekspertizës së hartuar, kjo për faktin se e njëjta është hartuar mënyrë profesionale dhe në përputhje me prova dhe gjendjen faktike të vërtetuar.

Gjykata, konform dispozitës së nenit 8 të Ligjit Nr. 03/L-006 për Procedurën Kontestimore lidhur me nenin 3 të Ligjit Nr. 03/L-007 për Procedurën Jokontestimore, bëri vlerësimin e secilës provë veç e veç, dhe të gjitha së bashku, dhe erdhi në përfundim se në këtë çështje juridike civile, duhet vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Në nenin 197 të LPJK-së, përcaktohet *“Në këtë procedurë jo kontestimore për ndarjen (pjesëtimin) e sendeve dhe paluajtshmërive në bashkëpronësi gjykata vendos për ndarjen dhe mënyrën e ndarjes së sendeve të tilla”*. Kurse, me nenin 198 paragrafi 1 të LPJK-së, përcaktohet se *“Procedurën e ndarjes së sendit dhe të paluajtshmërisë në bashkëpronësi mund ta inicioj me propozimin e tij secili nga bashkëpronarët”*. Ndërsa, paragrafi 2 i këtij neni përcakton se *“Propozimi i paraqitur në gjykatë duhet të përfshijë të gjithë bashkëpronarët. Propozimi duhet të përmbajë të dhënat për objektin e ndarjes, për madhësinë e pjesëve si dhe për të drejtat e tjera sendore të secili bashkëpronarë. Për sendet e paluajtshme duhet cekur të dhënat kadastrale dhe ato nga libri i paluajtshmërive Propozimit duhet bashkangjitur provat mbi të drejtën e pronësisë, të drejtën e servitutit dhe të drejta të tjera sendore, si dhe për posedimin e paluajtshmërisë”*. Sipas nenit 203 paragrafi 1 të LPJK-së, përcaktohet se *“Në qoftë se personat nga neni 202 i këtij ligji nuk arrijnë ujdë lidhur me kushtet dhe mënyrën e pjesëtimit, gjykata do të dëgjoj ata dhe do të marr prova, e kur ka nevojë do ta caktojë edhe ekspertimin, dhe në bazë të rezultatit të shqyrtimit të çështjes, në pajtim me dispozita përkatëse materiale-juridike, do të nxjerr aktvendimin për pjesëtimin e sendeve ose të paluajtshmërive në bashkëpronësi.*

Nisur nga faktet e vërtetuara më lart, gjykata vlerësoi se propozimi i propozuesve është i bazuar dhe të njëjtin e aprovoi duke bërë ndarjen (pjesëtimin) e paluajtshmërive, ashtu siç është specifikuar në diapozitivin e këtij aktvendimi.

Me rastin e marrjes së vendimit, gjykata mori parasysh kërkesat dhe interesat e justifikueshme të bashkëpronarëve.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës është marr në kuptim të nenit 29 paragrafi 3 të LPJK-së, pasi që asnjëra nga palët ndërgjyqëse nuk i ka kërkuar shpenzimet e procedurës.

Nga se u tha më lart, gjykata vendosi sikurse në dispozitiv të këtij aktvendimi, e në përputhje me nenin 197, 198, 203 paragrafi 1 dhe 2, dhe nenin 204 paragrafi 1 i LPJK-së.

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË – DEGA NË RAHOVC
Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Civil
CN.nr.33/2021, më datë 11.03.2024

Bashkëpunëtore profesionale
Adelina Çmega

Gjyqtari
Berkan Hamza

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktvendim, pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afatin prej 15 ditëve pas ditës së pranimit të të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, e nëpërmjet të kësaj gjykate.